



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:083379

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06114939

PKR.nr.224/16

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri, në çështjen penale kundër të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 302 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e evidentuar nën shenjë PP/I.nr.1255/2013, të datës 15.04.2016 (e parashtruar në gjykatë me datë 18.04.2016), duke vendosur lidhur me parashtrësën për kundërshtim të provave dhe hudhjen e aktakuzës, e parashtruar me datë 02.08.2024 nga mbrojtësi i të pandehurit N.P. avokat në Prishtinë (i caktuar sipas detyrës zyrtare), si dhe përgjigjes në kundërshtim të parashtruar me datë 12.08.2024 nga Prokuroria Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, jashtë seancës, me datë 27.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për kundërshtim të provave dhe hudhjen e aktakuzës, e parashtruar me datë 02.08.2024, nga mbrojtësi i të pandehurit A.R. , N.P. avokat në Prishtinë, ashtu që:

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e evidentuar nën shenjë PP/I.nr.1255/2013, e datës 18.04.2016 dhe PUSHOHET procedura penale, për veprën penale Falsifikim i parasë nga neni 302 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, kundër të pandehurit:

A.R. nga i ati R. dhe e ëma M. (e vajzërisë S.), i lindur me datë ... në fshatin Sh., Komuna P., me vendbanim në F. K., rruga “U.” objekti A..., hyrja ..., kati ..., numër ..., me numër personal të identifikimit ... të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy (2), ka të përfunduar shkollën e mesme ekonomike, punon: shofer i autobusit në K..., i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

III. Për shkak se ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, përkatësisht Prokurori i shtetit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor pas aktvendimit për fillimin e hetimit, nuk ka autorizuar policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave, nuk ka dhënë shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore e kjo në kundërshtim me nenin 104 paragrafi 4 dhe nenit 241 paragrafi 1 pika 1.7 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës në fuqi në kohën e hetimeve—Kodi Nr. 04/L-123 (në tekstin e mëtejme KPPRK).

IV. Shpenzimet e procedurës penale-paushalle bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

V. URDHËROHET – Konfiskimi i përhershëm i një kartëmonedhe me numër .... në vlerë prej 500,00 (pesëqind) euro.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, në këtë gjykatë me datë 18.04.2016 ka parashtruar aktakuzën e evidentuar me shenjën PP/I.nr.1255/2013, të datës 15.04.2016, kundër të pandehurit A.R., për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 302 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 23.01.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, ku kanë prezantuar Prokurori i shtetit A. H., i pandehuri A.R., si dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare N.P., avokat në Prishtinë.

Meqenëse i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, gjykata të njëjtin si dhe mbrojtësin e tij i ka njoftuar me të drejtat e tyre konform nenit 240 paragrafi 7 të KPPRK-së, ku të njëjtit brenda afatit kohor prej (15) ditëve, mund të paraqesin çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPPRK), si dhe çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 paragrafit 1 të KPPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit A.R. – N.P., avokat në Prishtinë (i caktuar sipas detyrës zyrtare), në afatin ligjor (datë 02.08.2024), ka parashtruar kërkesë për kundërshtim të provave dhe hedhjen e aktakuzës, i cili ndër të tjera ka theksuar provat, përkatësisht deklaratat e të pandehurit dhe të dëmtuarit në polici janë prova të pa pranueshme, nuk janë konfirmuar apo përgjigjur nga prokuroria, të gjitha veprimet janë kryer pa autorizim të Prokurorit. Nuk ka asnjë autorizim apo urdhëresë lëshuar nga Prokuroria, në mënyrë që policia të merr deklaratë me shkrim nga i pandehuri, që do të thotë se hetimet janë në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, ashtu që aktakuza e ngritur është e pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore. Prokuroria me datë 13.04.2016 merr Aktvendim PP.I.Nr.1255/2013 për fillimin e hetimeve kundër A.R., ndërsa pas dy dite me datë 15.04.2016 ngrit aktakuzën PP.I.nr.1255/2013 kundër të pandehurit A.R. Ku është qëllimi apo efekti i aktvendimit për fillimin e hetimeve, ku të gjitha veprimet janë kryer para nxjerrjes së aktvendimit. Të gjitha provat materiale të propozuara nga Prokuroria, asnjëra nga to nuk provojnë fare asnjë veprim inkriminues të të pandehurit A.R. me të cilin veprim kishte për të kryer veprën penale të përshkruar sipas aktakuzës. Nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte që provojnë mënyrën e veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri dhe në rastin konkret janë të parëndësishme provat e propozuara për çështjen dhe si të tilla duhet bërë përjashtimin e tyre, si prova qartazi të pa rëndësishme, e të cilat në kuptim të nenit 259 paragrafi 1 të KPPRK-së, konsiderohen prova të pa pranueshme. Nga të sipërsëhënuarat, gjykatës i kanë propozuar që të vendos si në propozimin e sipërsëhënuar, ngase, duke u mbështetur në këto prova të kundërshtueshme Prokuroria me datë 15.04.2016, ka ushtruar aktakuzën PP.I.nr. 1255/2013, kundër të pandehurit kinse për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale në fjalë, andaj mbi bazën e të lartcekurave është paraqitur kërkesa për hudhje të aktakuzës duke propozuar që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura.

Prokuroria e shtetit brenda afatit ligjor (datë 12.08.2024) në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje lidhur me kundërshtimet e provave dhe kërkesat për hudhjen e aktakuzës, duke theksuar se

pretendimet që janë cekur në kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit nuk qëndrojnë, përkatësisht nuk kanë bazë ligjore për një gjë të tillë. Aktakuza e ngritur kundër të pandehurit është ngritur në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara me KPPK-në dhe si e tillë mbështetet në prova të mjaftueshme dhe të pranueshme të cilat gjenden në shkresa të lëndës, e të cilat janë propozuar që të administrohen nga gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe pas administrimit të tyre do të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale të cekur si në aktakuzë. Andaj, nga të lartcekurat ka kërkuar nga gjykata që pas refuzimit të kërkesës nga mbrojtja e të pandehurit, të caktoj mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor për të proceduar tutje lidhur me çështjen penale.

Në rastin konkret gjykata ka gjetur se kërkesa e parashtruar për kundërshtim të provave dhe hudhje të aktakuzës, është e lejueshme, e njëjta është parashtruar brenda afatit ligjor nga personi i autorizuar sipas ligjit dhe si e tillë i plotëson kushtet ligjore që të shqyrtohet në themel, e njëjta është parashtruar sipas nenit 240 paragrafi 7, nën paragrafi 7.1 dhe 7.2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se: *“Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues informon të pandehurin dhe avokatin mbrojtës që ata mund të paraqesin propozimet e mëposhtme deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar: 7.1. çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë në pajtim me nenin 243 të këtij Kodi; dhe 7.2. çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës në pajtim me nenin 244 paragrafit 1 të këtij Kodi”*, e cila dispozitë nënkupton se i pandehuri dhe mbrojtësi i tij në këtë fazë të procedurës penale mund të e shfrytëzojnë këtë të drejtë ligjore.

Gjykata pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha provat të propozuara nga prokuroria, të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, pretendimet nga mbrojtësi i të pandehurit N.P. avokat në Prishtinë si dhe përgjigjen nga Prokurori i shtetit, ka vërtetuar se kërkesa për hudhjen e aktakuzës është e bazuar dhe si e tillë është aprovuar.

Gjykata fillimisht ka analizuar dispozitat ligjore të KPPRK-së, në fuqi në kohën e hetimeve, Kodi nr. 04/L-123, përkatësisht nenin 104, paragrafi 4 të të njëjtit, i cili ka paraparë se: *“Prokurori i shtetit mund të ndërmerr veprime hetimore ose të autorizojë policinë që të ndërmerr veprime hetimore lidhur me mbledhjen e provave”*, e që në shkresat e lëndës nuk kemi autorizim me të cilin prokurori i shtetit në rastin konkret e ka autorizuar policinë në ndërmarrjen e veprimeve hetimore. Në anën tjetër duke iu referuar dispozitës ligjore nga neni 151 paragrafi 1, i KPPRK-së, si më sipër, me të cilën ishte rregulluar çështja e Marrjes në pyetje e të pandehurit

në procedurë paraprake, dhe atë: *“Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për veprë apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t’i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim”*, në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se nuk është zbatuar dispozita përkatëse për faktin se bazuar në procesverbalin mbi intervistimin e të dyshuarit nga ana e Policisë, me numër të rastit 2013-AC-1269, datë 04.12.2023, i pandehuri A.R. është marrë në pyetje pa autorizim përkatës nga ana e prokurorit të shtetit, kurse dënueshmëria e veprës penale Falsifikim i paraparë nga neni 302 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, e cila i është vënë në barrë të pandehurit nga organi i akuzës, në mënyrë decisive ka përcaktuar se: *“Kur vepra penale nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni ka të bëjë me një shumë të parave të falsifikuara që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me jo më pak se tre (3) vjet burgim”* tutje paragrafi 1, i nenit në fjalë, ka përcaktuar se *“Kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për t’i vënë në qarkullim si të vërteta, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet”*.

Gjykata po ashtu gjatë vështrimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se prokurori i shtetit ka nxjerrë Aktvendim për fillimin e hetimeve me datën 13.04.2016, ndërsa me datën 15.04.2024, pra vetëm pas dy ditëve ka ngritur aktakuzën PP.I.Nr.1255/2013, të datës 15.04.2016, ndaj tani të pandehurit A.R. nën dyshimin se ka kryer veprën penale Falsifikimi i parasë nga neni 302 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së. Pra, Prokurori i shtetit nga data 13.04.2016 kur ka nxjerrë Aktvendimin për fillimin e hetimeve, e deri me datën 15.04.2024, në harkun kohor prej dy ditëve, kur edhe ka ngritur aktakuzën, nuk ka ndërmarrë as edhe një veprim procedural ndaj të pandehurit, pra thjesht ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve dhe menjëherë pa marrë as edhe një provë të vetme pas aktvendimit për fillim të hetimeve ka ngritur akuzën.

Kjo gjykatë fillimisht ka analizuar dispozitat ligjore të Kodit të procedurës penale në fuqi në kohën e hetimeve kur edhe ka ndodhur vepra penale e pretenduar, që i paraprijnë ngritjes së aktakuzës, mënyrën e marrjes së provave dhe stadet e procedurës penale, përkatësisht nenin 6 të KPPRK-së, i cili nen e ka rregulluar çështjen e Fillimit të procedurës penale. Në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar si vijon: *“Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83”*, tutje paragrafi 2 të nenit të lartcekur ka specifikuar si vijon: *“Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale”*. Në këndvështrim të dispozitës së lartcekur, Policia e Kosovës, ka ndërmarr

veprimet fillestare dhe ka njoftuar prokurorin e rastit lidhur me gjitha veprimet, por prokurori i rastit edhe pse i njoftuar me veprimet policore nga muaji Dhjetor i vitit 2013, nuk ndërmerr as edhe një veprim hetimor deri me datën 13.04.2016, ku edhe nxjerrët për herë të parë në aspektin formal Aktvendimi për fillimin e hetimeve, me ç'rast hetimi ka filluar me atë datë dhe pas kësaj date nuk ndërmerret as edhe një veprim hetimor e që rrjedhimisht nuk zhvillohen fare hetime.

Në shkresat e lëndës rezulton vetëm një vendim i prokurorisë, i evidentuar nën shenjë PPN-I-nr.634-5/2013, i datës 05.08.2013, me të cilin është obliguar Laboratori i Kriminalistikës në Prishtinë, që të bëjë ekzaminimin e dëshmisë – kartëmonedhave, i cili ekzaminim është urdhëruar pa pasur fare aktvendim për fillimin e hetimeve dhe madje pa specifikuar as të dyshuar dhe as se ndaj kujt po zhvillohen këto hetime dhe ndaj kujt po merren këto prova.

Kjo provë nuk është marrë as në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 të KPPRK-së, ku parashihet se : *“Hetimet policore mund të fillohen nga zyrtari i policisë në pajtim me nenet 69-83”* sepse nuk kanë qenë veprime fillestare të policisë, e as nuk janë marrë në përputhje me nenin 6 paragrafi 2 të po këtij Kodi, ku parashihet se: *“Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale”* , pasi që në rastin konkret prokurori i shtetit nuk ka filluar fare hetimet, andaj këto veprime të prokurorit të shtetit janë ndesh me bazamentet fundamentale të Kodit të Procedurës (i cili kishte qenë në implementim), e të përcaktuara në nenin 6 të po atij Kodi.

Neni 9 i Kodit të Procedurës Penale flet për parimin tjetër bazë të Kodit të Procedurës Penale: Barazia e palëve. Në paragrafin 1 është specifikuar se: *“Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë, tutje në paragrafin 2 është specifikuar se: “I pandehuri ka të drejtë të deklarohe dhe atij duhet t’i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t’i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t’i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij”*, ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar se: *“Nëse prokurori i shtetit vlerëson se gjatë hetuesisë janë mbledhur prova të mjaftueshme për të vazhduar në shqyrtim gjyqësor, prokurori i shtetit harton aktakuzën dhe paraqet faktet mbi të cilat ai e bazon aktakuzën dhe siguron provat për këto fakte”*.

Në këto rrethana procedura nga prokurori i shtetit është udhëhequr në shkelje të parimit bazë të KPPRK-së, atë të barazisë së palëve, pasi që është shkelur neni 9 paragrafi 2 i Kodit në fjalë, për faktin se prokurori i shtetit asnjëherë se ka njoftuar të pandehurin për ndonjë dyshim ndaj tij dhe se asnjëherë si ka mundësuar të njëjtit t'a njoftoj dhe t'i mundësoj t'i shfrytëzoj të drejtat e tij të parapara me nenin 9 paragrafi 2 të KPPRK-së. Tutje paragrafi 4 i nenit 9 të po këtij Kodi, e përshkruar si më sipër, ka specifikuar qartë si duhet të hartohet aktakuza, në rastin konkret prokurori i shtetit nuk ka zhvilluar fare hetime dhe ka ngritur aktakuzë, andaj aktakuza e ngritur nga prokuroria është në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 4 të KPPRK-së, pasi prokurori i shtetit ka ngritur aktakuzë pa ndërmarr as edhe një veprim të vetëm hetimor, por vetëm ka nxjerrë një aktvendim për fillimin e hetimeve, nuk ka ndërmarrë as një veprim procedural dhe ka ngritur aktakuzë, që përbën shkelje flagrante të të drejtave të njeriut të përcaktuara me dispozitat e nenit të lartcekur, por edhe me standardet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut e të mbështetura edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 68 i Kodit të Procedurës, ka përcaktuar në mënyrë decisive Fazat e procedurës penale. Sipas këtij Kodi procedura penale ka katër faza: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik.

Në vështrim të nenit 68 të Kodit të Procedurës, prokurori i shtetit nuk ka përfillur fare as fazat e procedurës penale, pra nuk e ka përfillur fare fazën e hetimit, ku edhe pse ka marrë një aktvendim për fillim të hetimeve nuk ka marrë as edhe një provë të vetme dhe pa as edhe një veprim të vetëm, pas dy ditëve ka ngritur aktakuzë që rrjedhimisht ka kapërcyer statet e procedurës penale duke bërë shkelje të nenit 68 të KPPRK-së, dhe një qasje të tillë të ushtruar nga organi i akuzës, nuk e akcepton - tejkalon në asnjë formë kjo gjykatë.

Në nenin 102 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës specifikon si vijon: *“Prokurori i shtetit mund të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se po ndodh ose ka gjasë të ndodh në një të ardhme të afërt vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare”,* andaj referuar dispozitës përkatëse, prokurori i shtetit, vet fakti se ka konsideruar se ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale është kryer edhe ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve, por i njëjti nga dyshimi i arsyeshëm që ka specifikuar në aktvendimin për fillimin e hetimeve me datën 13.04.2016, me datën 15.04.2016 vetëm pas dy ditëve ka konstatuar

se ka dyshim të bazuar mirë dhe ka ngritur aktakuzën, ani pse nuk ka ndërmarr as edhe një veprim hetimor, për çka në bindjen e kësaj gjykate një qasje e tillë është e paprecedent.

Në nenin 103 paragrafi 1 të KPPRK-së, është specifikuar si vijon: *“Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit çmon jo vetëm rrethanat dhe provat fajësuese por edhe ato shfajësuese, dhe siguron marrjen e provave të cilat mund të mos jenë të mundshme në shqyrtim gjyqësor”*. Në rastin konkret, prokurori i shtetit ka shpërfillur dispozitën e lartcekur, pasi që pas fillimit të hetimeve prokurori i shtetit nuk e ka marr as edhe një provë të vetme e që rrjedhimisht nuk ka mundur fare të zbatoj nenin 103 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës, sepse nuk pa pasur se çfarë prova dhe rrethana të çmoj për aç kohë sa nuk ka ndërmarr as edhe një provë të vetme e që shfaq haptazi neglizhencën e hetimeve dhe trajtimin e këtij rasti.

Tutje në nenin 103 paragrafi 2 të KPPRK-së është specifikuar si vijon: *“Qëllimi i hetimit është që të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo të pushohet procedura dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jetë e pamundshme apo e vështirë që të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor”*, ashtu që duke ju referuar dispozitës së sipërcituar konstaton se qëllimi i hetimit është mbledhja e provave për t’u determinuar fakti po që se ka bazë ose jo për ngritjen e akuzës. Në rastin konkret, prokurori i shtetit nuk ka mbledhur as edhe një provë të vetme, gjë që gjykata nuk e ka të qartë se si i ka nxjerrë përfundimet për ngritjen e aktakuzës kur nuk ka zhvilluar fare hetime, e që bie ndesh me vet qëllimin e hetimeve të përcaktuar me nenin 103 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit në fjalë.

Në nenin 103 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës është përcaktuar si vijon: *“Çdo person për të cilin prokurori i shtetit ka dyshim të arsyeshëm se ka kryer veprë penale duhet të ceket si i pandehur në aktvendimin për fillimin e hetimit. Çdo i pandehur i cekur në vendim gëzon të gjitha të drejtat që i takojnë të pandehurit me këtë Kod”*, i pandehuri është specifikuar në aktvendimin për fillim të hetimeve si i pandehur, por i njëjti nuk ka gëzuar as edhe një të drejtë me këtë Kod, pasi që as që është ndërmarr ndonjë veprim hetimor ndaj tij, por prokurori i shtetit direkt ka ngritur aktakuzën pa ndërmarr as edhe një veprim hetimor dhe aktakuzën e ka ngritur pas vetëm dy ditëve dhe në këto formë vazhdon me shkeljet e dispozitave të Kodit të Procedurës dhe të drejtave të pandehurit në procedurë.



Në neni 104 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës është paraparë se: *“Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake”*, tutje paragrafi 5, i nenit të sipër cekur parasheh se: *“Hetimi kryhet vetëm lidhur me veprën penale dhe me të pandehurin e përcaktuar në aktvendimin mbi fillimin e hetimit apo në aktvendimin e ndryshuar”*. Siç është specifikuar në nenin e lartcekur, hetimet zhvillohen ndaj personit të caktuar për veprën e caktuar penale. Kur prokuroria kishte lëshuar vendim me të cilin e kishte obliguar Laboratorin e Kriminalistikës në Prishtinë, të bëjë ekzaminimin e monedhave të dyshuara, e njëjta nuk kishte marrë fare aktvendim për fillim të hetimeve, pra s’kishte pasur aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj personit të caktuar dhe ndaj veprës penale të caktuar, për çka rrjedhimisht çdo provë e marrë nga prokurori i shtetit në kundërshtim me nenin 104 paragrafi 1 dhe 5 të KPPRK-së, është provë inekzistente që nuk i referohet rastit konkret, respektivisht personit të caktuar dhe veprës penale të përcaktuar në aktvendimin për fillimin e hetimeve, andaj të gjitha veprimet e prokurorit në këtë rast nuk gjejnë mbështetje në parimet bazë të Kodit të Procedurës.

Për me tepër neni 241 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të KPPRK-së ka përcaktuar si vijon *“Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore”*, në rastin konkret Prokurori i shtetit nuk ka dhënë asnjë shpjegim se cili ka qenë rezultati i hetimit pasi ka marrë aktvendimin për fillimin e hetimit me shenjë PP.I.Nr.1255/2013, të datës 13.04.2016, e që nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor por pas dy dite ka ngritur aktakuzën, përkatësisht me datë 15.04.2016.

Në nenin 248 paragrafin 1 të KPPRK-së (08/L-032), tani i zbatueshëm është përcaktuar si vijon: *“Për çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se: vepra me të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale; ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht*

nga gjykata; nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë dhe aktakuza nuk është ngritur brenda afatit të paraparë në nenin 234 të këtij Kodi”. Kjo gjykatë konstaton se procedura penale nga prokurori i shtetit është zbatuar në kundërshtim me nenet e specifikuara si më sipër, e të cilat kanë qenë të zbatueshme në atë kohë dhe se prokurori i shtetit ka marr disa veprime procedurale pa pasur fare aktvendim për fillimin e hetimeve, ndërsa prej momentit që ka marr aktvendimin për fillimin e hetimeve nuk ka ndërmarr asnjë veprim procedural në kuptim të ndjekjes dhe se direkt ka ngritur aktakuzën. Në anën tjetër i pandehuri A.R., është marrë në pyetje nga ana e zyrtarëve policor pa autorizimin përkatës nga ana e prokurorit të shtetit, në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 151 paragrafi 1 të KPRK-së, e cila ka qenë në fuqi, andaj gjykata në këto rrethana e hedhi aktakuzën ndaj të pandehurit A.R. dhe pushoi procedurën penale.

Duke vërejtur një qasje ndaj hetimeve të paprecedent, kjo gjykatë ka bërë analizë ligjore dispozitave të Kodit të Procedurës për të nxjerrë përfundimet se si ka mundur prokurori i shtetit në këtë mënyrë të ngritë këtë aktakuzë. Për gjatë analizës ligjore të elaboruar më sipër, ka rezultuar se ngritja e aktakuzës ka ardhur pas shkeljeve të parimeve thelbësore të vet konceptit të Kodit të Procedurës, duke shkelur kështu parimet e procedurës penale, stadet e procedurës penale, mënyrën e zhvillimit të hetimeve, mbledhjen e provave dhe të drejtat e të pandehurit në procedurë, duke zhvilluar hetimet – mbledhë provat dhe ngritur aktakuzën në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPPRK-së.

Kjo gjykatë konstaton se, një qasje e tillë siç është vepruar në këtë rast nga organi i akuzës që ka kësaj lloji qasje ndaj një hetimi penal dhe ndjekje penale mjaft serioze, për këtë gjykatë është i pa pranueshëm. Kjo gjykatë konsideron se, secili organ kushtetues duhet t’i kryej veprimet e veta procedurale në përpikëri duke respektuar në plotni standardet e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi dhe se gjykatat në asnjë formë nuk duhet t’i tejkalojnë këto shkelje të bëra nga organi i akuzës, sepse në atë formë do kalonin në kompetenca të organit të akuzës e që rrjedhimisht do të tejkaloheshin edhe kompetencat e gjykatës që ka për obligim për të ruajtur standardin e hetimeve, marrjen e provave dhe barazinë e palëve në procedurë.

Kjo gjykatë konstaton se shkeljet e tilla flagrante, asesi nuk mund të kalojnë në shqyrtimin gjyqësor dhe se shqyrtimi i provave dhe zbardhja e të vërtetës mund të iniciohet vetëm atëherë kur paraprakisht prokurori i shtetit ka zhvilluar hetimet dhe ka mbledhur provat në mënyrë strikte

duke zbatuar dispozitat ligjore në implementim gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast dhe i ka pamundësuar kësaj gjykate të kaloj në shqyrtimin gjyqësor dhe të zbardh gjendjen faktike dhe rrjedhimisht kjo gjykatë nuk ka pasur zgjidhje tjetër veç se të hedhë aktakuzën ndaj të pandehurit A.R. dhe të pushon procedurën penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e një kartëmonedhe në vlerë prej 500,00 (pesëqind) euro, me numër X01004901140, është marrë në përputhje me nenin 302 paragrafi 6 të KPRK-së, lidhur me nenin 276 paragrafi 1 dhe 2, pika 2.5 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e konform nenit 248 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.224/16, datë 27.08.2024

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,  
Gazmend Bahtiri

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej dhjetë (10) ditëve, nga momenti i pranimit të aktvendimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.